

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare, Gëzim Llulluni dhe Nora Bllaca-Dula, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditëses G. (S.) S. nga fshati, Komuna e Podujevës, kundër të paditurit M.B. nga fshati ..., Komuna e Drenasit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.B., avokat nga Prishtina, për shkak të kontaktit me fëmijën, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të t' paditurit e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Glllogoc, C.nr.209/2018, i datës 27.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.05.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të autorizuarit t' paditurit M.B. nga fshati ..., Komuna e Drenasit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Glllogoc, C.nr.209/2018, i datës 27.11.2018, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.209/2018, të datës 27.11.2018 në pikën I (një) të dispozitivit e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses G. S. nga fshati Dumnicë e Poshtme, Komuna e Podujevës, fëmijën e mitur A. S. e lindur me datë 29.07.2015 në Prishtinë, në bashkësinë jashtëmartesore nga babai M.B. dhe nëna G. S., ia ka besuar në ruajtje, edukim dhe kujdes babait – këtu të paditurit M. (R.) B. nga fshati ..., Komuna e Glllogocit, sipas marrëveshjes së prindërve të fëmijës pa detyrim tani për tani për pagimin e alimentacionit nga paditësja G. (S.) S. – nënë e fëmijës. Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka caktuar kontaktin e paditëses G. S. me fëmijën e mitur A. S. e lindur me datë 29.07.2015 në Prishtinë dy herë në muaj, të premtën e dytë dhe të premtën e fundit të çdo muaji duke filluar prej orës 13.00 deri në orën 15.00 në lokalet e QPS në Glllogoc, derisa të ekzistojnë kushtet ligjore (në rast se dita e caktuar e kontaktit bie ditë fundjave apo feste që nuk punon QPS-ja, kontakti i radhës mbahet ditën e parë të punës pas fundjavës-festës) si dhe e ka detyruar të paditurin M. (R.) B. që t' ia dorëzoj fëmijën e mitur A. S. në orarin e caktuar të kontaktit në lokalet e QPS-së në Glllogoc në mënyrë që të realizohet kontakti personal me fëmijën-nënë e saj, paditësen G. S.. Në pikën III (tre) të dispozitivit ka vendosur që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i të paditurit në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe ta kthejë çështjen në rigjykim në

gjykatën e shkallës së parë me detyrim që gjykata fillimisht të zbatoj dispozitën e nenit 3 par 1.2 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim.

Ankesa e të autorizuarit të t 'paditurit i është dërguar paditëses për përgjigje, por e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të t 'paditurit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja G. S. nga Prishtina, me datë 11.07.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kontakt me fëmijën, kundër të paditurit M.B., me të cilën ka kërkuar që të aprovet kërkesëpadija e paditëses si e bazuar dhe të vendoset kontakti i nënës G. S. nga fshati Dumnicë e Poshtme, Komuna e Podujevës me vajzën e mitur A. S., dy herë në muaj dhe atë të premtën e dytë dhe të premtën e fundit të muajit, kontakti të bëhet në QPS në Prishtinë dhe të detyrohet i padituri që të paguaj shpenzimet e procedurës, në afatin prej 15 ditësh nga plotëfuqishmëria e aktgjykimit.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestuese, ka caktuar shqyrtimin kryesor, ka administruar provat dhe ka marrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.209/2018, i datës 27.11.2018, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata ka theksuar se palët ndërgjyqëse kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore dhe se në këtë bashkësi ka lindur vajza e mitur A. S., e regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile në Podujevë, në ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile evidentohen vetëm të dhënat e njërit prind- nënës G. S., ndërsa një muaj pas lindjes së fëmijës përkatësisht me dt. 30.08.2015 fëmija A. S. i është dhënë në përkujdesje dhe ruajtje me marrëveshjen e palëve babait M.B. nga fshati ..., Komuna e Gllogocit dhe se që nga ajo kohë fëmija jeton dhe është në përkujdesjen e babait të saj – këtu të paditurit.

Lidhur me mënyrën e vendosjes si në pikën I të dispozitivit, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si provë materiale ka administruar edhe anamnezën sociale të hartuar nga Qendra për Punë Sociale në Gllogoc, të datës 12.11.2018, ku organi i kujdestarisë ka dhënë mendimin e tij që fëmija i mitur A. S. e lindur me datë 29.07.2015 t'i besohet të paditurit në ruajtje dhe edukim, duke mbajtur kontaktet e rregullta me nënën e saj dy herë në muaj, me arsyetim se kushtet ekonomiko-sociale janë të mira, ku i padituri jeton me standard të mirë jetësor, është në marrëdhënie pune, realizon të ardhura mujore 280 €uro, i njëjti po ashtu posedon shtëpi prej 120 m², e mobiluar mirë dhe e pajisur mirë, e cila i plotëson kushtet për një jetë normale. Njëherit çështja e besimit të fëmijës nuk ishte kontestuese as në mes palëve ndërgjyqëse.

Lidhur me mënyrën e vendosjes si në pikën II të dispozitivit, gjykata duke u bazuar edhe në mendimin e Qendrës për Punë Sociale si dhe rrethanave tjera siç është mosha e fëmijës ka caktuar kontaktin e nënës me fëmijën e mitur, duke vlerësuar se kontakti i fëmijës së mitur me nënën i ndihmon në zhvillimin e drejtë psiko fizik të fëmijës dhe mirërritjen e saj.

Gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurit se duhet të ndërpritet procedura kontestimore deri në zgjidhjen e çështjes paraprake në procedurën administrative në mënyrë që të regjistrohet fëmija i mitur A. S. në regjistrin amë të të lindurve me të dhënat e të dy prindërve biologjik nëna G. S. dhe babai M.B. dhe të regjistrohet me mbiemrin B., por nuk e ka aprovuar me arsyetimin se nuk ishte fakt kontestues nga prindërit e fëmijës – këtu palët ndërgjyqëse atësia e as amësia e fëmijës, ndërsa regjistrimi i fëmijës në regjistrin qendror të gjendjes civile- Librin Amzë të të Lindurve me të dhëna të plota të të dy prindërve biologjik është në kompetencë të procedurës administrative, ndërsa kontakti me fëmijën dhe besimi i fëmijës është çështje e cila duhet trajtuar me urgjencë dhe i domosdoshëm për mbrojtjen e fëmijës i cili kontakt ka ndikim në zhvillimin e drejtë psiko-fizik të fëmijës dhe plotëson boshllëkun e jetës së ndarë me dy prindërit.

Për bazë juridike gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e mori duke iu referuar dispozitave nga neni 140, neni 137 paragrafi 2, 145 paragrafi 1 të Ligjit për Familjen i Kosovës, neni 50 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 3 paragrafi 1 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës , ndërsa vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në dispozitën e nenit 450, 452.2 të LPK-së dhe nenin 347 të LFK -së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore në lidhje me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së, sepse aktgjykimi i atakuar është krejtësisht i qartë, dispozitivi është i kuptueshëm e po ashtu është në përputhje edhe me arsyet e aktgjykimit. Lidhur me arsyetimin e aktgjykimit, gjykata i është përmbajtur me korrektësi dispozitave që përcaktojnë strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit, ndërsa në mënyrë specifike arsyetimi i aktgjykimit në vetvete paraqet një përmbajtje koherente me rrjedhë logjike edhe për gjendjen e fakteve të konstatuara nga gjykata, për provat e administruara, për vlerësimet e gjykatës lidhur me faktet dhe besueshmërinë e provave, e po ashtu edhe për kualifikimin e këtyre fakteve në raport me normat materialo-juridike.

Gjykata ankimore vlerëson se pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore duke mos i dërguar palët ndërgjyqëse në ndërmjetësim të detyrueshëm siç parashihet me dispozitën e nenit 3 paragrafi 1.2 dhe neni 9 të Ligjit për Ndërmjetësimin Nr.06/L-009, janë të pabazuara ngase fakti se gjykata e shkallës së parë nuk i ka informuar dhe obliguar palët në procedurën e ndërmjetësimit nuk paraqet shkelje e cila do të ndikonte në drejtëshmërinë e vendimit, pasi që ushtrimi të kësaj padie në gjykatë i ka paraprirë një marrëveshje në mes të këtu palëve ndërgjyqëse dhe se shumica e fakteve në mes tyre nuk ishin kontestuese, ndërsa palët ndërgjyqëse një mundësi të marrëveshjes e kanë pasur edhe në gjykatë gjatë të procesit gjyqësor e edhe tutje.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 278 par. 1 pika a) dhe neni 13 të LPK-së për ndërprerjen e procedimit të kësaj çështjeje deri në zgjidhjen e çështjes paraprake në procedurën administrative nuk qëndrojnë dhe se gjykata ankimore e mbështetë në tërësi vlerësimin e gjykatës së shkallës

së parë të dhënë në arsyetimin e vendimit për vazhdimin e procedimit të kësaj çështjeje ngase dispozita e nenit 278 paragrafi 1, pika a) të LPK-së, mund të aplikohet në rastet kur gjykata ka vendosur që vet të mos e zgjidhë çështjen paraprake, pra sipas kësaj dispozite gjykata i vlerëson rrethanat e parapara nëse duhet të ndërpritet procesi gjyqësor dhe merr vendim për ndërprerje ndërsa dispozita e nenit 13 parasheh se : “Kur vendimi i gjykatës varet nga zgjidhja paraprake e çështjes se a ekziston ndonjë e drejtë subjektive apo marrëdhënie juridike, e lidhur me të ende nuk ka marrë vendim, gjykata apo organi tjetër kompetent (çështja paraprake), atëherë gjykata ka tagër që vetë ta zgjidhë çështjen e tillë, në qoftë se me dispozita të veçanta nuk është caktuar ndryshe.....”, ndërsa në rastin konkret kërkesëpadia ka për objekt vendosje një të drejtë subjektive civile të pretenduar nga ana e palës paditëse- caktimi i kontaktit me fëmijën e mitur, për të cilën gjykata e shkallës së parë mund të vendos në mënyrë meritore pa u ndërlidhë me çështjen administrative, gjithashtu në mes të këtu palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese atësia dhe amësia e fëmijës dhe se regjistrimi i fëmijës në regjistrin qendror të gjendjes civile- Librin Amzë të Lindurve me të dhëna të plota të të dy prindërve biologjik nuk shërben si çështje paraprake në këtë çështje juridike kontestimore.

Është i pabazuar pretendimi ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për faktin se gjykata e shkallës së parë mbi bazën e fakteve jo kontestuese si dhe provave të administruara drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe si rezultat ka aplikuar drejtë të drejtën materiale.

Gjykata ankimore e ka pranuar në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me besimin e fëmijës dhe caktimin e kontaktit, për shkak se vlerëson se me provat e administruara në këtë çështje juridike kontestuese gjykata ka ndjekur parimin e interesit më të mirë të të miturit i cili rrjedhë si detyrim për gjykatën në Konventën për të Drejtat e Fëmijës e zbatuar drejtpërdrejt në Kosovë dhe po ashtu edhe nga dispozitat e Ligjit për Familjen i Kosovës.

Në këtë rast gjykata është thelluar në masë të mjaftueshme në interesin e fëmijës dhe në mbështetje të fakteve jokontestuese, ndërsa atyre kontestuese të vërtetuara me provat e administruara, ka konstatuar të gjitha faktet me rëndësi për të vendosur. Në këtë rast gjykata përmes anamnezës sociale ka konstatuar se rrethanat ekonomike dhe sociale diktojnë se interesi më i mirë i të miturës është që e njëjta t’i besohet babait të saj këtu të paditurit për shkak se ajo nga shkëputja e bashkësisë jashtëmartesore jeton me të njëjtin dhe është e lidhur emocionalisht me babain. Gjithashtu nga anamneza sociale konstatohet se kushtet ekonomike tek i padituri janë të favorshme që të njëjtit t’i besohet fëmija. Gjykata ankimore me rastin e pranimit të përfundimit të gjykatës së shkallës së parë nuk është udhëhequr nga kriteri ekonomik por nga kriteri psikosocial, respektivisht lidhja e fëmijës me prindërit, në këtë rast me të paditurin. Përveç kësaj edhe mos ndërrimi i ambientit për fëmijën i shkon në favor vendimit të gjykatës që fëmija t’i besohet babait.

Lidhur me besimin e fëmijës e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, në këtë rast me referencë në dispozitat e nenit 143 paragrafi 2 të LFK-së.

Sa i përket vendimit për kontaktin gjykata ankimore vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur pasi që mënyra e caktimit të kontaktit garanton ruajtjen dhe kultivimin e marrëdhënies në mes të fëmijës dhe prindit me të cilin nuk jeton fëmija.

Do të ishte shumë e favorshme për fëmijën që prindërit të merren vesh gjithmonë për mënyrën e realizimit të kontaktit pavarësisht vendimit të gjykatës në mënyrë që tek fëmija mos të vërehet në asnjë formë rezistence apo pakënaqësie e prindërve përkitazi me mënyrën e realizimit të kontaktit. Përndryshe përfundimi i gjykatës është i drejtë dhe me këtë rast e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë me referencë në dispozitat nga neni 140 dhe 145 të LFK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.103/19, me datë 06.05.2019

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka, d.v